



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Rregulloren komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas Konfirmimit/Kërkesës të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural datë 02.08.2024, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. [redacted], me vendbanim në fshatin Metehi Komuna e Podujevës, nr. personal 1 [redacted] përfitues në projektin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural “Përkrashje me Mëshqerra” sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës nr. prot. 02-400/01-0048961/24 datë 26.07.2024 lirohet nga participimi në shumën prej 30 % të vlerës së projektit përkatësisht 810 €, participim të cilën i njëjti e kishte përmbushur në projektin e njëjtë të vitit të kaluar (12.10.2023), ku ishte përzgjedhur përfitues.

Neni 2

Lirimi nga participimi sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet mbi bazën e Konfirmimit/Kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit sipas të cilit fermerit përfitues në vitin 2023 i kishte ngordhur mëshqerra brenda disa ditësh nga pranimi i saj dhe atë brenda afatit kontraktues, por që nuk është arritur t'i bëhet zëvendësimi me një mëshqerrë tjetër nga ana e operatorit/furnizuesit në këtë projekt dhe i njëjti ka mbetur pa mëshqerrë edhe përkundër faktit që ka qenë përfitues dhe ka kryer obligimin e participimit nga ky projekt.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit.
z.Nazmi Haliti, (njoftohet përmes DBPZHR-së)

Nr.Prot.02-400/05-0050957/24
Podujevë, datë 02.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT Nr.prot.02-020/04-0043346/24 të datës 04.07.2024

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr.prot. 02-020/04-0043346/24, i datës 04.07.2024, Për Ngritjen e Komisionit AD-HOC Për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve dhe atë në vend të z.Remzi Kodraliu caktohet z.Rilind Babatinca, zyrtar në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 2

Zëvendësimi bëhet për shkak se zyrtari z.Remzi Kodraliu, është angazhuar në komisione punë dhe detyra tjera të punës brenda institucionit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërse e vendimi nr.prot. 02-020/04-0043346/24, i datës 04.07.2024.

*U dërgohet:
Të caktuarit.
Kryesuesit së komisionit.
Ddrejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
QSHQ/Arkivit.*

Nr. Prot 02-016/01-0051363/24
Podujevë, datë 05.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes thirrjes publike të datës 11.07.2024, nxjerr;

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE PËR ORGANIZMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE RINORE DHE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve, për financimin publik të programeve/projekteve sipas thirrjes publike në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, publikuar më datë 11.07.2024, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- 1.Arbër Sfishta,** kryesues, zyrtar për kulturë – DKRS.
- 2.Ardonis Jusufi,** anëtar, zyrtar i të hyrave financiare- DBF.
- 3.Alban Shabani,** anëtar, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme -DBF.
- 4.Fatmire Fusha,** anëtare, shoqëria civile.
- 5.Gazmend Ahmeti,** anëtar, shoqëria civile.

znj.Venoza Zullufi, zyrtare për biblioteka 4, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0053187/24
Podujevë, datë, 12.08.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dëronar më Dostavljeno	12.08.2024	
Nisbi.org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-464/01-0053604/24		
PODUJEVË - ПОДУЈЕВО		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 4,7 dhe 8 paragrafi 5 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.02-464/01-22232/24 të datës 05.04.2024 të Drejtorisë Arsimit për iniciimin e procedurës së shpronësimit, merr:

VENDIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR SHQYRTIM TË MËTEJTMË

Neni 1

Miratohet shqyrtimi i mëtejtmë i kërkesës së Drejtorisë së Arsimit për shpronësimin e parcelave në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim në detaje të paluajtshmërive, si në shtojcë të këtij Vendimi.

Neni 2

Kërkesa për shpronësim do të shqyrtohet në procedurë të mëtejme me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik për realizimin e projektit "Ndërtimi i Çerdhes" paraparë me Hartën Zonale të Komunës së Podujevës (HZK) për periudhën 2022 -2030, e miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. prot. 01-020/02-0030654/, datë 29 prill 2022.

Neni 3

Vlerësimi i pronave sipas nenit 1 të këtij vendimi caktohet nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajtshëm në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave si dhe Drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht nevojave të paraqitura në funksion të realizimit të këtij projekti.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen e Komunës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Qendrës së Shërbimit për Qytetarë
- Në dosje

Podujevë, datë: 12.08.2024

02-464/01-53604/24

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliq



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja n) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, Ligjin nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr. 11/ 2010, për Licencimin e Qendrave Rinore, nenet 16 dhe 19 shkronja n) të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e Qendrës Rinore Publike datë 18.07.2024, merr:

VENDIM

PËR LICENCIMIN E OJQ-së “ SHOQATA RINIA PËR EDUKIM DHE ANGAZHIM PËR LLAPJANËT ” SI QENDËR RINORE PUBLIKE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

OJQ “Shoqata Rinia për Edukim dhe Angazhim për Llapjanët” licençohet si Qendër Rinore Publike në Komunën e Podujevës.

Neni 2

OJQ sipas nenit 1 licençohet me qëllim të ofrimit dhe sigurimit të kualitetit të shërbimeve rinore, hapësirave, resurseve si dhe mundësive për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale, dhe të veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë.

Neni 3

OJQ “Shoqata Rinia për Edukim dhe Angazhim për Llapjanët” licençohet për periudhën katër (4) vjeçare.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-016/01-0053324/24
Podujevë, Datë: 12.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026 nr.prot.01-413/01-0071612/23, dt.27.09.2023, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0009833/24 të datës 08.02.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, sipas Ftesës Publike nr.prot. 15-300/01-0044981/24 të datës 11.07.2024, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e njëmbëdhjetë (11) përfituesve me pajisje pune në Komunën e Podujevës.

2. Mbështetja financiare bëhet sipas kushteve dhe kriterëve sipas Ftesës publike për aplikim në projektin “Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve”(Vazhdim i implementimit të projektit), përkatësisht subvencionimi në vlerë totale në fazën e dytë 30,700.00 €, nga e cila 70% apo 21,490.00 € financim nga Komuna, ndërsa participimi i përfituesve bëhet në vlerë 30% për një përfitues apo 9,210.00 € të shumës së investimit të përcaktuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bizneseve ekzistuese dhe bizneset Start Up në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesëve të përzgjedhur për implementimin e projektit: *Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve*, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Subvencionimit përkatësisht mbështetja financiare do të bëhet me akt të veçantë për secilin përfitues veç e veç pas verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e përfituesit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5


Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Komisionin përkatës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. ~~02-400/01-0053697/24~~
Podujevë, datë: 12.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të ojq-ve në Komunën e Podujevës për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta, sipas Thirrjes publike, nr. prot 06-400/03-0027908/24, datë 29.04.2024, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATATAT JOQEVERITARE -OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta, sipas Thirrjes publike datë 29.04.2024, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **20,000.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekt/programeve sipas nenit 1 dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/01-00549/14/24
Podujevë, 15.08.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulhiqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, nxjerrë:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Grupi punues për hartimin e Draft Planit të Mobilitetit për periudhën 2025 - 2029, në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Fatmir Emini , <i>Inxhinier i makinerisë dhe Master i komunikacioni rrugor,</i>	<i>kryesues</i>
Bujar Blaku , <i>Inxhinier i komunikacionit rrugor dhe Master i sigurisë rrugore,</i>	<i>anëtar</i>
Nexhat Kastrati , <i>Inxhinier i makinerisë dhe Master i komunikacioni rrugor,</i>	<i>anëtar</i>
Mirlinda Zulfaj , <i>zyrtare për transport - Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	<i>anëtare</i>
Mirlinda Arifi , <i>zyrtare ligjore - Drejtorja e Arsimit,</i>	<i>anëtare</i>

Neni 2

Grupi punues sipas këtij vendimi, do të hartojë Draftin e Planit të Mobilitetit në Komunën e Podujevës për periudhën kohore 2025 – 2029, në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 3

Grupi punues për punën e kryer informon Zyrën e Kryetarit të Komunës përmes Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-020/d4-0057801/24
Podujevë, datë: 26.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13, 58 shkronja g) dhe nenin 67 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nenin 29 paragrafi 1.1 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, dhe nenet 16, 61 paragrafi 1.7 dhe nenin 69 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, duke vepruar sipas neneve 14 dhe 19 të Kodit të Etikës nr.prot.01-110/05-0054239/20 për zyrtarët e Komunës së Podujevës, si dhe sipas aktit / formularit nr.prot.02-016/01-0057796/24 të datës 24 gusht 2024 për deklarimin e konfliktit të interesit të paraqitur nga z.Sabedin Namani, nxjerr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Në vend të z.Sabedin Namani, udhëheqës i zyrës ligjore - Komuna e Podujevës, dhe anëtar i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-360/02-0076268/22 datë 05.09.2022, në rastin e lëndës së z.Iliaz Selmanit për blerjen e banesës komunale për të cilën ekziston e drejta banesore, të paraqitur me kërkesën nr.prot.08-463/02-0085686/22 të datës 05.10.2022, caktohet;

z.Halit Vërshefci, udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri caktohet anëtar ad-hoc në Komisionin përkatës, vetëm për rastin e shqyrtimit të lëndës sipas Kërkesës nr.prot.08-463/02-0085686/22 datë 05.10.2022, për arsye se anëtari i Komisionit z.Sabedin Namani ka deklaruar konfliktin e interesit lidhur me rastin në fjalë për shkak se është në lidhje familjare me bashkëshorten e parashtruesit të Kërkesës, dhe specifikimeve tjera të paraqitura në deklarimin e konfliktit të interesit (bashkëngjitur këtij vendimi), ku i njëjti edhe ka kërkuar që në këtë rast të lirohet nga cilësia e anëtarit të komisionit të cekur për shkak të konfliktit të interesit.

Neni 3

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.02-360/02-0076268/22 të datës 05.09.2022 për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Zyrtarit të caktuar
Anëtarëve të Komisionit përkatës (përmes kryesuesit të Komisionit)
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/05-0057975/24
Podujevë, datë, 26.08.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026, në implementim të projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0037290/24 të datës 07.06.2024, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0043346/24 të datës 04.07.2024 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 97,620.00€, nga e cila 68,334.00€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 29,286.00€ apo 30% e vlerës participim nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me mekanizëm bujqësor", përkatësisht për 94 fermer përfitues, dhe atë për;

- Mbjellëse pneumatike të misrit me plehërim 6 rendor,.....2 fermer përfitues
- Mbjellëse të misrit mekanike me plehërim,.....2 fermer përfitues
- Plug rrotullues 4 rendor 12'3 fermer përfitues
- Freza 1.8 m,.....15 fermer përfitues
- Mmotokultivator me frezë,.....16 fermer përfitues
- Frezë për motokultivator 12HP,.....56 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-401/01-0057995/24
Podujevë, datë, 26.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafët 5 dhe 6 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.02-400/04-0055329/24 të datës 16.08.2024 të OJQ-së “Shoqata vullnetare e zjarrëfiksave-Podujeve”, merr:

V E N D I M **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE** **OJQ-në “SHOQATA VULLNETARE E ZJARRËFIKSAVE - PODUJEVË”**

Neni 1

OJQ “Shoqata vullnetare e zjarrëfiksave – Podujevë”, për mbulimin e shpenzimeve të trajnimit të zjarrfikësve vullnetar në Qendrën e Trajnimeve në Vushtrri, për shuarjen e zjarrit dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ “Shoqata e zjarrëfikësve vullnetar – Podujevë” .

Neni 3

Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të Rregullores së cekur.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-400/01-0058142/24
Podujevë, datë, 27.08.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Shuajb Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, derisa z.Bahri Selimi Drejtor i Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 29.08.2024 deri më 02.09.2024.

Me këtë njoftohen:

I autorizuari

Qendra e Shërbimit për Qytetarë

Zyra e Personelit

Nr.Prot. 02-016/01-0058876/24
Podujevë, datë: 29.08.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafët 1.8; 1.13 dhe 1.15 të Rregullores komunale për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0046963/24 të datës 19.07.2024, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit përmes Kërkesës nr.prot.02-400/04-0047006/24 datë 19.07.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [REDAKTUAR], nga fshati Siboc i Poshtëm - Komuna Podujevës, për organizimin e aktiviteteve kulturore dedikuar vajzave dhe grave Llapjane përfshirë edhe nga diaspora, përmes realizimit të punëtorive artizanate me qëllim të promovimit të traditave, kulturës dhe zakoneve kulturore në Llap me theks zhvillimin e aftësive të ndryshme përmes pjesëmarrjes në aktivitete kulturore, mbështetet me mjete financiare në shumë 3000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj. Teutë Gërguri (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.Prot. 02-400/01-0059530/24
Podujevë, datë, 30.08.2024

